



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0826

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "AS Tech" SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Komuna E Vushtrrisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim dhe instalimi i pajisjeve për klimatizim” me numër të prokurimit VU644-23-7744-1-2-1, me 26/12/2023, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht të bazuar ankesa e OE "AS Tech" SH.P.K., me nr. 2023/0826 , e datës 23/10/2023, kurse vendimi i AK Komuna E Vushtrrisë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim dhe instalimi i pajisjeve për klimatizim” me numër të prokurimit VU644-23-7744-1-2-1.
2. Mbetet në fuqi vendimi i autoritetit kontraktues
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik "AS Tech" SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 28.07.2023, Komuna E Vushtrrisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizim dhe instalimi i pajisjeve për klimatizim” me numër të prokurimit VU644-23-7744-1-2-1. Ndërsa me datën 02.10.2023 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë për “Adnani Group SH.P.K”.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 36,140 €..

Me 07.10.2023, OE "AS Tech" SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 12.10.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 23.10.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "AS Tech" SH.P.K., me nr. 826/23 lidhur me aktivitetin “Furnizim dhe instalimi i pajisjeve për klimatizimë” me numër të prokurimit VU644-23-7744-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "AS Tech" SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): “Parashtrorjmë këtë Ankesë kundër Vendimit të AK-se Komuna e Vushtrrisë të datës 02.10.2023, ku AK shpërblen me kontratë për projektin “Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve të klimatizimit”, OE të papërgjegjshëm. Argumentimet tona i kemi parashtruar edhe në Kërkesën për rishqyrtim por AK përsëri eka mbrojtur vendimin e tij dhe e ka refuzuar Kërkesën tona për rishqyrtim. Vlerësimin se pretendimet tona janë të bazuar i mbështesim pas vlerësimit të dokumentacionit të OE të rekomanduar Adnani group, pas qasjes në dokumentacion. Nga qasja që patëm në dokumentacion vërejtëm se OE nuk i ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit si vijon: Kapaciteti teknik dhe profesional- .Operatori Ekonomik duhet të ketë përmbushur furnizime të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit nga data e publikimit e njoftimit për kontratë minimum me vlerë 47,000 euro. Në rast të grupit të OE ,lideri i grupit duhet të ketë realizuar se paku 60 % përqind nga vlera totale e kërkuar.”

Pretendimi i dytë (II) “OE në oferte ka dorëzuar vetëm disa fatura ose kontrata shumicën me blerës privat ndërsa listën e kontratave edhe pse ka qene kërkesë e ka dorëzuar pas kërkesës për sqarime të AK-se. OE në liste të kontratave të dorëzuar ka kontrata të ndryshme por që nuk e plotësojnë kërkesën e dosjes sepse nuk janë të natyrës së klimatizimit, përveç kontratës me KEK të gjitha kontrata tjera në liste nuk janë të pranueshme për këtë projekt, dhe si e tillë oferta duhet të eliminohet. Kontrata me KEK është në vlerë 7070 euro ndërsa kërkesë e AK-se ka qene

Kontrata të natyrës së ngjashme në vlerë 47.000 euro. Këtë e themi në bazë të Udhëzuesit të prokurimit publik 01/2023 Neni 10.1 sqarimi i tenderëve: Problemi - Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës së përcaktuar. Si të veprohet - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm”.

Pretendimi i tretë (III) *“OE në oferte përveç që lista e tij nuk i përmbush kërkesat e AK-së po ashtu ka sjell kontrata me blerës privat që çdo kontrata e bërë mes dy palëve ka të njëjtën strukturë, ku dallon vetëm titulli ose të dhënat bazike. Po ashtu edhe referencat që Blerësit i kanë lëshuar OE “Adnani Group”, të gjitha referencat nga blerësit privat kanë të njëjtën strukturë, kjo është shumë e çuditshme, sepse po të ishte rasti që vetë OE “Adnani group” ju lëshon referenca të tjerëve është normale të jetë forma njëjtë, ndërsa palët tjera kontraktuese private të përdorin një formë identike për të lëshuar reference OE në fjalë është shumë shumë e çuditshme. Po ashtu edhe kërkesën për të sjell foto dëshmi bashkë me specifika të pajisjeve nuk e kasjell sipas kërkesës së dosjes. Këto pretendime që i kemi cekur janë parashtruar edhe në kërkesë për rishqyrtim ndërsa AK në vijë të përgjithshme e ka refuzuar Kërkesën tone dhe nuk na ka dhënë detaje që ikundërshtojnë pretendimet tona”.*

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "AS Tech" SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 7, 59, 60, 69 . Duke i propozuar që nga OSHP kthim të lëndës në rivlerësim dhe shpërblim të ofertës tone me kontratë sepse oferta e “As Tech” është me e lira e përgjegjshme.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 31/10/2023 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 826/23, ndërsa me datë 13/11/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0826 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertja shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, “Autoriteti kontraktues nuk ka kthyer përgjigje . Ndërsa OE Nuk Pajtohet me raportin e eksperti shqyrtues”

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "AS Tech" SH.P.K., ekspertja shqyrtuese përmes raportit nr. 202/0826 ka vlerësuar si në vijim:

-Konstatimi i ekspertës shqyrtuese - (I): *“Nga qasja që patëm në dokumentacion vërejtëm se OE nuk i ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit si vijon: Kapaciteti teknik dhe profesional. Operatori Ekonomik duhet të ketë përmbushur furnizime të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit nga data e publikimit e njoftimit për kontratë minimum me vlerë 47,000 euro. Në rastet e grupit të OE, lideri i grupit duhet të ketë realizuar së paku 60 % përqind nga vlerat totale të kërkuara. OE në ofertë ka dorëzuar vetëm disa fatura ose kontrata shumicën me blerës privat ndërsa listën e kontratave edhe pse ka qenë kërkesë e ka dorëzuar pas kërkesës për sqarime të AK-së. OE në listë të kontratave të dorëzuar ka kontrata të ndryshme por që nuk e plotësojnë kërkesën e dosjes sepse nuk janë të natyrës së klimatizimit, përveç kontratës me KEK të gjitha kontrata tjera në listë nuk janë të pranueshme për këtë projekt, dhe si e tillë oferta duhet të eliminohet. Kontrata me KEK është në vlerë 7070 euro ndërsa kërkesë e AK-së ka qenë Kontrata të natyrës së ngjashme në vlerë 47.000 euro.”* **Eksperti shqyrtues sqaron** që një nga kërkesat e DT-së sa i përket kapacitetit teknik dhe profesional ka qenë si më poshtë: *Siç mund të shihet dhe më lartë, nga Operatorët Ekonomik është kërkuar që të dorëzojnë me ofertë edhe dëshmi sa i përket realizimit të projekteve me furnizime të ngjashme në tre vitet e fundit, përkatësisht listën e këtyre kontratave të realizuara. Eksperti shqyrtues pasqyron që pas analizimit të listës së kontratave të dorëzuar nga OE i rekomanduar, nga kjo listë shihet se është vetëm një kontratë e cila nuk mund të konsiderohet si kontratë e natyrës së ngjashme ashtu siç është kërkuar me Dosje të Tenderit dhe ajo është kontrata e furnizimit me kamina. Duke marrë parasysh që klima hynë në kuadër të teknikës së bardhë, sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit, çdo kontratë e cila është realizuar si furnizim me pajisje që i përkasin teknikës së bardhë, bënë pjesë në furnizime të natyrës së ngjashme. Kontratat të cilat janë pjesë e listës dhe të dëshmuara edhe me referenca, përmbushin vlerën e kontratave të kërkuara. Andaj, nga kjo çfarë sqaruar më lartë, eksperti vlerëson që pretendimi i OE ankues nuk është i bazuar.”*

-Konstatimi i ekspertës shqyrtuese- (II): *OE në ofertë përveç që lista e tij nuk i përmbush kërkesat e AK-së po ashtu ka sjell kontrata me blerës privat që çdo kontratë e bërë mes dy palëve ka të njëjtën strukturë, ku dallon vetëm titulli ose të dhënat bazike. Po ashtu edhe referencat që Blerësit i kanë lëshuar OE “Adnani Group”, të gjitha referencat nga blerësit privat kanë të njëjtën strukturë, kjo është shumë e çuditshme, sepse po të ishte rasti që vete OE “Adnani group” ju lëshon referenca të tjerëve është normale të jete forma njëjtte, ndërsa palët tjera kontraktuese private të përdorin një formë identike për të lëshuar referencë OE në fjalë është shumë shumë e çuditshme. Po ashtu edhe kërkesën për të sjell foto dëshmi bashkë me specifika të pajisjeve nuk e ka sjell sipas kërkesës së dosjes. Këto pretendime që i kemi cekur janë*

parashtruar edhe ne kërkesë për rishqyrtim ndërsa AK ne vija të përgjithshme e ka refuzuar Kërkesën tone dhe nuk na ka dhënë detaje që i kundërshtojnë pretendimet tona.” Sa i përket pretendimit se OE i rekomanduar ka sjellur shumicën e kontratave me blerës privat, eksperti sqaron që përderisa në Dosje të Tenderit nuk është ndarë asnjë kriter se sa përqind e kontratave duhet të jenë të realizuara me autoritete publike të Kosovës e sa me blerës privat, nuk mund të pretendohet se OE i rekomanduar ka shkelur kriteret e Dosjes së Tenderit. Andaj përderisa nuk ka pasur një kërkesë të tillë në DT ky pretendim nuk mund të konsiderohet i bazuar.

-Konstatimi i ekspertës shqyrtuese- (III): *“Ndërsa sa i përket pretendimit tjetër se OE i rekomanduar nuk ka sjellë foto dëshmi bashkë me specifikat e pajisjeve siç është kërkuar në DT, eksperti pasqyron që një pretendim i tillë qëndron dhe është i bazuar, për faktin që edhe pse në DT është kërkuar që “OE duhet të paraqesë, tek Autoriteti kontraktues të paktën nga një foto për secilin produkt të ofruar, së bashku me një përshkrim të karakteristikave teknike të produkteve të lëshuara nga prodhuesi”, OE i rekomanduar në katalogun e dorëzuar ka paraqitur specifikat e pajisjeve sipas kërkesave por jo edhe foto dëshmitë, andaj konsiderojmë që në këtë pikë, OE i rekomanduar nuk ka përmbushur mjaftueshëm kërkesat teknike dhe profesionale të Dosjes së Tenderit.”*

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues "AS Tech" SH.P.K., Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e eksperteve mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "AS Tech" SH.P.K., janë pjesërisht të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës ka gjetur se ankesa është pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Vushtrisë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim dhe instalimi i pajisjeve për klimatizim” me nr. të prokurimit: VU644-23-7744-1-2-1. Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar konform dispozitave ligjore të LPP, pasi që AK ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese OE pjesëmarrës, duke u bazuar në dokumentacionin e prezantuar dhe dëshmitë dëshmuese me pas ka rekomanduar OE me ofertën më të lirë të përgjegjshëm. Paneli Shqyrtues vlerëson se vlerësimi i tenderit është kryer sipas kërkesave të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe dosjes së tenderit. Andaj, Paneli Shqyrtues vlerëson se AK me të drejt ka shpërblyer OE e rekomanduar pasi që ka përmbushur gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e

tenderit si dhe ka qenë tenderi me i përgjegjshëm me çmim me të ultë.

Paneli shqyrtues mendon se Autoriteti Kontraktues ka zbatuar drejt dispozitat e LPP. Komisioni i vlerësimit ka bere verifikimin e dokumenteve te parashtruara ne baze te kërkesave nga dosja e tenderit dhe ka qene i kujdesshëm qe te vlerësoj saktë dhe me vërtetësi dokumentet e dorëzuara nga OE, prandaj përgjigjet eksperti shqyrtues për panelin shqyrtues janë bindëse dhe ja fal besimin sa i përket përgjigjeve në pretendimin 1 dhe 2 të radhitura si në raportin e ekspertizës, por paneli shqyrtues sa i përket përgjigjes së në pretendimin 3 nuk pajtohet me ekspertin shqyrtues që aktiviteti i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim, për derisa OE i rekomanduar për kontratë sipas ekspertit shqyrtues në katalogun e dorëzuar ka paraqitur specifikat e pajisjeve sipas kërkesave të dosjes së tenderit, andaj, paneli shqyrtues vendos që aktiviteti i prokurimit mos të prolongohet dhe mos të kthehet në ri-vlerësim vetëm që të kërkohen sqarime shtesë dhe të sjellen fotot si dëshmi, sepse kjo nuk është në dobi të asnjërës palë.

Andaj, rrjedhimisht paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës, bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimet ankimore të OE ankues janë pjesërisht të bazuara, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e panelit.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur ne konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkëljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E VUSHTRRIË**
- **OE - " AS Tech " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: